

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Pershkrimi i detyres

Sistemi që kërkohet për administrimin e taksave, tarifave, shërbimeve dhe administrimit financiar duhet të jetë itipit COTS (Commercial Off The Shelf) të njohur ndërkombëtarisht, duke u bazuar nga ana teknologjike në paketa ndërkombëtare të ndërtuara mbi bazën e praktikave më të mira dhe në modelin e implementuar në disa njësi të qeverisjes vendore, gjatë projekteve të ndryshme në vitet e fundit.

Sistemi që do të propozohet duhet të jetë lehtësisht i konfigurueshem për paketa fiskale lokale, si dhe duhet të jetë në përputhje të plote me rregullat dhe standardet e kontabilitetit publik dhe legjislativin në fuqi. Gjithashtu duhet konceptuar me funksione të zgjerueshme në të ardhmen. Zgjidhja do të synojë të mbulojë plotësisht të gjitha aktivitetet në lidhje me taksat, tarifën dhe shërbimet si dhe aktivitetet financiare të njësive.

Modulët kryesorë përberës të këtij sistemi duhet të jenë:

- Moduli i Taksapaguesit
- Moduli i Paketës Fiskale
- Moduli i Gjenerimit të Detyrimeve
- Moduli i Administrimit të Debitoreve
- Moduli i Administrimit të Arketimeve
- Moduli i Rivlersimit

Hapesira gjeografike që do të mbulohet

Bashkia Skrapar dhe 8 njësi në varesi të saj.

Grupet e synuara

Ky projekt synon grupet e mëposhtme të interesit:

- Të gjithë punonjësit e Bashkisë Skrapar dhe njësive administrative në varesi të saj.
- Punonjësit e zyrave të Teknologjisë së Informacionit të Bashkisë Skrapar
- Punonjësit e zyrave të Taksave dhe Tarifave vendore të Bashkisë Skrapar
- Të gjithë palet e treta, biznese dhe qytetare të qytetit të Çorovodës të cilët marrin shërbime nga kjo bashki dhe njësi administrative në varesi të saj.

Siguria e sistemit

Siguria e te dhenave duhet te arrije ne nivel rekordi specifik per çdo tabele te dhenash. Ne menyre qe tu jepet akses perdoruesve sipas nevojave, akses mund te jete specifik per disa funksione si psh: lexim te dhenash, modifikim, ekzekutim dhe fshirje. Me anë të kredencialeve me të cilat logohen në ambientin e tyre të punës (kodit të përdoruesit dhe fjalëkalimit), përdoruesit mund të logohen në panelin e administrimit sipas rolit përkatës për të manaxhuar sistemin.

Përdoruesit do jenë të ndarë sipas roleve dhe të drejtave të caktuara nga administratori. Në bazë të llojit të autorizimit që një përdorues i caktuar ka, ai mund të ketë të drejtë për të: shtuar, modifikuar ose fshirë një option specifik nga një fushë e përzgjedhur.

Aksesi ne sistem do te kryhet ne baze te parimit RoleBase Access Control (RBAC). Rolet per secilin punonjes qe do te kete akses ne sistem do te percaktohen gjate zhvillimit te projektit. Stafii bashkise do te kryejë ndarjen e roleve dhe operatori është i detyruar ta zbatojë këtë ne projekt.

Te gjitha te dhenat e ruajtura ne aplikacion, perfshire edhe ato te konfigurimit si dhe te perdoruesve te sistemit duhet te ruhen ne nje baze te dhenash RDBMS e cila ploteson kerkesat ne lidhje me integritetin e te dhenave dhe sigurine.

Sistemi duhet te suportoje mjete eficente auditimi, mjete eficente per aktivizimin e ruajtjes se historikut dhe te ndryshimeve, percaktimin e historikut te se shkuars dhe te ardhmen (modifikim, shtim, fshirje). Ruajtja duhet te realizohet per te dhena specifike ne tabela, te cilat mund te zgjidhen nga administratorët e sistemit.

Përcaktimi i nivelit të sigurisë si dhe disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit është bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

| Disponueshmëria | Integriteti | Konfidencialiteti | Niveli i Sigurisë |
|--|--|--|---------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> D0 | <input type="checkbox"/> I0 | <input type="checkbox"/> K0 | |
| <input type="checkbox"/> D1 | <input type="checkbox"/> I1 | <input type="checkbox"/> K1 | <input type="checkbox"/> U |
| <input checked="" type="checkbox"/> D2 | <input checked="" type="checkbox"/> I2 | <input checked="" type="checkbox"/> K2 | <input checked="" type="checkbox"/> M |
| <input type="checkbox"/> D3 | <input type="checkbox"/> I3 | | <input type="checkbox"/> L |

Detyrat specifike

Ne kuader te qellimit kryesor te ketij projekti per ndertimin e sistemit te taksave dhe atij financiar e kontabel, i gjithë projekti duhet te ndertohe mbi detyrat e meposhteme:

1. Percaktimi i planit te punes per ekzekutimin e projektit
2. Ngritja e grupeve te punes nga te dy palet e interesuara
3. Mbledhja, specifikimi dhe dokumentimi i analizes se kerkesave
4. Dizenjimi dhe percaktimi i arkitektures se sistemit
5. instalimi fizik dhe konfigurimi i serverit ku do te implementohet sistemi
6. Testim i funksionit normal te serverit
7. Zhvillimi dhe implementimi i sistemit Financiar dhe te Taksave
8. Konfigurimi dhe integrimi me sistemet e tjera si QKR, Gjendje Civile, Ministria e Financave
9. Konfigurimi i sistemit dhe migrimi i te dhenave fillestare
10. Testimi dhe dokumentimi i pranimit te perdoruesit
11. Pergatitja e materialeve udhezuese dhe trajnimi i perdoruesve
12. Marrja ne dorezim e projektit nga autoriteti kontraktues
13. Raportimi i cdo faze te projektit te menaxheret e projektit.

1.1. Kerkesat e Raportimin

Kontraktuesi do te paraqese raportet e meposhtme ne gjuhen shqipe ne origjinal dhe ne 2 kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 12 faqesh duhet te prodhohet pas 3 jave, nga fillimi i implementimit. Ne raport Kontraktuesi duhet te pershkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi ne mbledhjen e te dhenave, çdo veshtiresi te pritura ose te hasura pervec programit te punes apo udhetimeve te stafit. Kontraktuesi duhet te vazhdoje me punen e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues te dergoj komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit perfundimtar** i faqeve maksimale 12 (teksti kryesor, duke perjashtuar anekset) Ky raport duhet te dorezohet jo me vone se nje muaj para perfundimit te periudhes se zbatimit te detyrave.
- **Raporti final** me te njejtat specifika si drafti i raportit perfundimtar, inkorporimin e komenteve te pranuar nga palet ne draft raport. Afati i fundit per dergimin e raportit perfundimtar eshte 10 dite pas marrjes se komenteve ne draft raportin perfundimtar. Raporti perfundimtar duhet te sigurohet se bashku me faturen perkatese.

1.2. Dorezimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i permendur me siper duhet t'i dorezohet Menaxherit te Projektit te identifikuar ne kontrate. Menaxheri i Projektit eshte pergjegjes per aprovimin e raporteve.

2. KOMUNIKIMI ME SISTEME TE TJERA

Bazuar ne legjislacionin e kzistues per bazat e te dhenave shteterore, per te shmangur gabimet humane ne hedhjen e te dhenave dhe per te rritur eficencen ne pune eshte i nevojshem aksesi dhe shkembimi i te dhenave te meposhtme me regjistrat elektronike ekzistues apo qe jane duke u ndertuar. Per kete arsye duhet te ndertohen nderfaqe me:

- Nderfaqe me gjendjen civile
- Nderfaqe me qendren e regjistrimit te bizneseve

| NR | Emri i Nderfaqes | Pershkrimi | Drejtimi |
|----|-----------------------------|---|----------|
| 1 | Gjendja civile | Do marre te dhenat personale te individit | Hyrje |
| 2 | Qendra Kombetare e Biznesit | Te dhena te subjekteve | Hyrje |

Specifikimi i fushave qe do te perdorin per cdo nderveprim:

- **Regjistrin e Gjendjes Civile** - Për të dhënat e gjeneraliteteve të aplikantëve nëpërmjet Nr. Personal; Në dijeninë tonë ky shërbim ofrohet nga regjistri i gjendjes civile. Parameter hyrës: NID
Parametra dalës:
 - NID
 - Emri
 - Mbiemri
 - Atesia
 - Rruga
 - Gjinia
 - Vendlindja
 - Datelindja
 - Memesia
 - Kodzgjç
 - Gjendja civile
 - Emri NJQV

- Lidhje me kryefamiljarin
- Emri Qarkut
- Emri Rrethit
- NrIDC
- TypeDoc
- Date Leshimi
- Date Skadence
- ID Familjes
- Kodi QV

Regjistrin e QKB

Parametër hyrës: NUIS

Parametra dalës:

- NUIS
- Emri i subjektit
- Aktiviteti
- Data regjistrimit
- Status i Subjektit
- Adresa e Subjektit

3. GARANCIA

Ne kuader te kesaj kontrate kompania e kontraktuar duhet te mbuloje nje periudhe 1 vjecare garancie te sistemit, si dhe minimalisht 3 vjet per pajisje hardware

4. Mirembajtje

Bashkia Skrapar ka si qellim te sigurojne vijueshmerine, disponibilitetin dhe performance te larte te sherbimeve te sistemit financiar dhe ate te taksave. Ne kuader te ketij bashkepunimi kompania duhet te ofroje sherbimet e listuara me poshte per nje periudhe 4-vjecare pas marrjes ne dorezim te sistemit.

- Fillimi i diagnostikimeve on site / on line, dhe mbeshtetje per "debugging" brenda dites te punes nga njoftimi i Autoritetit Kontraktor dhe perfundim te veprimeve korigjuese brenda 24-48 oreve nga ky njoftim.
 - Mbeshtetje me linje telefonike ne gjuhen Shqipe, deri ne 2 ore pergjigje ne nje dite pune.
 - Emergjenca per thirrje, sherbim vizitash ne vend (on site) brenda dites te punes nga marrja e kerkeses se Autoritetit Kontraktor.

- Sherbim on site / on line “per thirrje” per personalizimin e paketes se programit, e vlefshme brenda dites pasardhese te punes.
- Mirembajtje te Bazes se te Dhenave.
- Asistence per personelin IT per:
 - Analize te te dhenave.
 - Implementim te proçedurave te backup /restore dhe disaster recovery automatike dhe manuale.
 - Gjenerim te raporteve te performances.
- Helpdeskte jete aktiv 8 ore nga e Hena ne te Premten (08:00 – 16:00).
- Korrigjimi i gabimeve te funksionaliteteve.
- Ri-instalimi i sistemit mete gjithe komponentet e tij, do te jete detyrimi i kompanise se bashku me konfigurimet perkatese per venien ne pune te ketij programi (server dhe kliente).
- Çdo ndryshim i kryer si pasoje e ndryshimeve ligjore finaciare dhe fiskale duhet te kryhet me prioritet brenda nje afati te tille qe nuk do te sjelle pengese ne realizimin e detyrave te Deges se Taksave te cilat mbeshteten mbi kete sistem.
- Kompania duhet te jete disponibel per ndryshimet ne raportet perkatese sipas kerkeses se bere nga Bashkia Skrapar si per ato ekzistuese dhe per raporte te reja ne kuader te permiresimit te punes ne sektorin finaciar.
- Ndryshimi i raporteve dhe faturave te cilet do te printohen ne pamjen vizuale mund te jene subjekt permiresimi.
- Konfigurimi i klienteve dhe userave te rinj apo i atyre ekzistues ne Bashkine Skrapar.
- Trajnimi i personelit perdorues per ndryshimet apo permiresimet e tij ne ambientet e Bashkise Skrapar.
- Pergatitje te raporteve 3-mujore tedetajuara lidhur me punen e kryer nga kompania.

TE DREJTAT E KODIT TE APLIKACIONIT

Te gjitha te drejtat mbi kodin burim dhe dokumentacionin teknik do t'i perkasin Autoritetit Kontraktor. Sistemi do te dorezohet i shoqeruar me kodin burim te strukturuar dhe te komentuar, se bashku me setin e dokumentacionit teknik qe perfshin dokumentacionin teknik te moduleve ne vecanti dhe dokumentin teknik ne teresi.

KERKESAT FUNKSIONALE

Sistemi duhet te bazohet ne paketa programi gjithepershireshe nderkombetare te ndertuara ne menyre modulare dhe bazuar ne role dhe detyra. Çdo modul duhet te jete plotesisht i integruar me pjeset e tjera te sistemit.

- Sistemi duhet te jete i mbeshtetur ne aplikacione COTS te cilat kane baze te gjere implementimi ne Shqiperi, rajon dhe ne Evrope.
- Sistemi duhet te jete i integrueshem me paketen office excel, word, outlook.

- Sistemi duhet te jete i integrueshem me 'active directory' dhe te suportoje konceptin 'Single Sign-on'.
- Sistemi duhet te bazohet ne nje pakete programi gjithepershireshe nderkombetare te ndertuar ne menyre modulare dhe bazuar ne role dhe detyra. Çdo modul duhet te jete plotesisht i integruar me pjeset e tjera te sistemit.
- Sistemi duhet te funksionoj me nje baze te dhenash te vetme
- Paketa e zgjedhur duhet te jete fleksibel ne parametra, dhe pershtatjet specifike te japin efektin e duhur, duke shmangur nevojën për të bërë porosi për zhvillimin e programit,.
- Sistemi duhet te kete si pjese integrale nje ambjent zhvillimi te pajisur me mjetet e duhura per personalizim menush, objektesh, formash, faqesh dhe raportesh, pa patur nevojën për të nderhyrë në 'source code' te sistemit.
- Çdo funksion procesimi i sistemit duhet te bashkeveproje me funksionet e tjera te sistemit ne menyre sa me te integruar, duke minimizuar nderhyrjet e perdoruesit.
- Sistemi duhet teshoqerohet me pershkrime te detajuara te platformes se teknologjise se programit (ambjentin e zhvillimit, serverat e aplikimit, çdo program standard shtese dhe/ose ambjente ekzekutimi) qe jane perdorur per zhvillimin e sistemit.
- Nderfaqja e sistemit duhet te jete e modelit "Role Based", e konfigurueshme sipas profileve te punonjesve.
- Siguria e te dhenave duhet te arrije ne nivel rekordi specifik per çdo table te dhenash. Ne menyre qe tu jepet akses perdoruesve sipas nevojave, akses mund te jete specifik per disa funksione si psh: lexim te dhenash, modifikim, ekzekutim dhe fshirje.

Modulet kryesore te sistemit duhet te jene si me poshte:

- Moduli i Taksapaguesit
- Moduli i Paketës Fiskale
- Moduli i Gjenerimit të Detyrimeve
- Moduli i Administrimit të Debitoreve
- Moduli i Administrimit të Arketimeve
- Moduli i Rivlersimit

Funksionalitete dhe Bllokskema

Funksionalitetet e zgjidhjes se ofruar duhet te jene si me poshte:

- ***Sistemi i Administrimit te Taksave dhe Tarifave duhet te mundesoje:***
 - Administrimin e regjistrimit te taksapagueseve
 - Informacion mbi taksapaguesin i grupuar ne kartela, lista, dhe fast tab-e me te gjitha fushat e nevojshme
 - Informacion i shpejte mbi situaten e taksapaguesit

- Integrim me Microsoft Office Outlook per ndjekjen e task-eve.
 - Link-e me dokumentat (kontratat etj.)
 - Raporte dinamike shoqeruar me ilustrime grafike.
- ii. Administrimin e paketes fiskale**
- Informacioni mbi taksat te jete i grupuar ne kartela, lista dhe fast tab-e.
 - Percaktohet teresia e parametrave te nevojshem sipas nevojave lokale.
 - Lista te taksave momentale dhe periodike
 - Kartela te taksave momentale dhe periodike
 - Mundesi per te kontrolluar periudhen e vlefshmerise per nivelin e taksave per njesi ndermjet afateve
- iii. Administrimin e te gjitha llojeve te te ardhurave te njesise**
- iv. Mundesi te palimitura ne numrin dhe llojin e te ardhurave qe njesia do te administroje.**
- v. Administrim te automatizuar te penaliteteve (gjobat)**
- Percaktim i penaliteteve sipas kategorive te taksapagueseve
 - Llogaritje automatike dhe azhornim I detyrimeve
 - Printim njoftim detyrimeve per cdo taksapagues ose ne grup ne baze te filterave qe aplikohen.
- vi. Llogaritje te automatizuar te interesave**
- vii. Administrimin e arkave te njesise**
- Celje arkash per mbledhjen e arketimeve sipas nevojave te NJQV-se
 - Regjistrim dhe aplikim automatik te arketimeve nga arkat e bashkise
 - Regjistrim i arketimeve nga thesari
 - Nderfaqe per marrje pagesash nga thesari.
 - Regjistrim te dhenash nga statement te marra nga bankat
 - Llogaritje automatike penaliteti ne momentin e regjistrimit te pageses
- viii. Administrimin e debitoreve**
- Identifikimin e debitoreve te grupuar ne periudha
 - Opsione per ndarjen e debitoreve sipas zonave dhe inspektoreve
 - Dergime automatike me email te situates debitore per biznese dhe qytetare
 - Dergime me mesazh te gjendjes debitore

- Printim te njoftim detyrimi ne cdo moment
- Mbi 30 raporte per analiza te debitoreve.

ix. Rivlersim te detyrimeve te taksapaguesit

- Procedura per rivlersimin e detyrimeve

x. Administrimin e kontabilitetit

- Cdo veprim qe kryhet ne moduln e taksave automatikisht kryen regjistrimin kontabel duke prekur llogarite kontabel.
- Percaktim te skemave kontabel
- Analiza dhe raporte kontabel ne lidhje me taksat, tarifat, gjobat dhe interesat e llogaritura

xi. Administrimin e buxheteve

- Regjistrim te buxheteve ne nivel takse dhe tarife
- Regjistrim i planit vjetore te te ardhurave
- Krahasim automatik ne cdo moment me faktin
- Raporte dhe dashborde me ilustrime grafike.

xii. Akses online per taksapaguesit per te pare detyrimet tatimore

- Akses online ne cdo moment per te pare situaten financiare

xiii. Admnsitrim dhe profile te dedikuara te perdorueseve

- Krijim profilesh perdoruesish sipas rolit qe ka ne NJQV. Cdo perdorues mund te shohe dhe kryej veprime vetem ne te dhenat qe i eshte dhene e drejta.
- Personalizim te nderfaqes ne nivel perdoruesi

xiv. Nderfaqe interaktive

- Nderfaqet e sistemit te dizenjohen ne baze te roleve
- Nderfaqet te mund te personalizohen deri ne nivel perdorusi
- Nderfaqet duhet te aksesohen nga aplikacioni i perdoruesit qe instalohet ne kompjuterin e perdoruesit si dhe nga browser te ndryshem si interent explorer, Google Chrome dhe Mozilla

xv. Raporte interaktive

- Raporte te printueshme
- Raporte analizash
- Raporte te shoqeruara me grafik

- Raporte dinamike qe gjenerohen ne baze te parametrave qe vendosen paraprakisht.
- xvi. **Modul te dedikuar per procesin e validimit te te dhenave te prones dhe tokes buqesore**
- Marrje te dhenash nga hipoteka per te vleresuar dhe kalkuluar taksen e prones
 - Marrje te dhenash nga burime te tjera ne formatin excel
 - Transferim automatik te te dhenave te konfirmuara ne TAIS
 - Marrje kordinatash te prones dhe adreses se pronarit direkt nga harta (google maps, bing)
 - Lokalizim te prones ne harte.
- xvii. **Sistemi duhet te furnizohet me te dhena te perditesuara nga burime te ndryshme si hipoteke, gjendje civile, qendera kombetare e regjistrimit te biznesve, ministria e financave etj.**

Ky informacion do te mund te sigurohet nepermjet ESB- te. Per kete qellim duhet te ndertohen:

- Nderfaqe me Zyren e Regjistrimit te Pronave
- Nderfaqe me gjendjen civile
- Nderfaqe me thesarin
- Nderfaqe qendren e regjistrimit te bizneseve

Taksat dhe Tarifat Vendore

Pushteti vendor ne vendin tone parashikon nje sere taksash dhe tarifash nder te cilat permendim :

- Taksa e regjistrimit te pervitshem te mjeteve
- Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja
- Taksa e fjetjes ne hotel
- Tarifa te Institucioneve te varesise
- Tarifa per sherbime ne drejtorine e taksave
- Tarifa per njesite Bashkiake
- Tarifa e sherbimit administrativ
- Tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave
- Tarifa e parkimit te automjeteve
- Taksa vendore mbi biznesin e vogel
- Taksa per zenien e hapësirave publike
- Taksa e tabelës
- Taksa mbi pasurine e paluajtshme
- Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise. etj

Ne vecanti Taksa mbi Pasurine e paluajtshme eshte nje nga burimet kryesore te te ardhurave qe gjeneron pushteti vendor, dhe subjekt i saj jane te gjithe personat fizike ose juridike, vendas ose te huaj, pronaret e pasurive te paluajtshme ne territorin e Republikes se Shqiperise, pavaresisht nga niveli i shfrytezimit te kesaj pasurie. Pronari ose bashkepronaret jane te detyruar te paguajne taksen

mbi pasurine e paluajtshme, ne baze te perqindjes se prones ne posedim. Taksa mbi pasurine e paluajtshme perfshin:

- a. **Taksa mbi ndertesat;**Baza e takses mbi ndertesat eshte siperfaqja e ndertimit (vendi) ne metra katrore te ndertimit apo pjese te tij, mbi dhe nen nivelin e tokes, dhe siperfaqja e çdo kati.
- b. **Taksen mbi token bujqesore;** Baza e takses mbi token bujqesore eshte siperfaqja e tokes bujqesore ne hektare, ne pronesi te tatimpaguesit.

Siperfaqja ne pronesi te tatimpaguesit vleresohet ne baze te dokumenteve qe vertetojne nje pasuri te tille.Baza per sistemin e takses se pasurise varet nga saktesia e sistemit te regjistrimit te pasurise. Pa nje informacion te sakte dhe aktual te pronesise se pasurive, te karakteristikave te prones dhe bazen e informacionit per metodat e vleresimit, taksa e pasurise nuk do te siguroje nivelin e te ardhurave,

| | |
|------------------|---|
| Procesori | 2 cpu, me performancëminimale ≥ 9900 sipas benchmark tëpublikuar në http://www.cpubenchmark.net" |
|------------------|---|

nivel qe duhet te jete i ndershem dhe i barabarte per te gjithë qytetaret taksapagues te kesaj takse. Aktualisht ne Shqiperi pergjegjesia per ngritjen dhe mirembajtjen e sistemit te regjistrimit te pasurive i perket Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme. Per kete arsye integrimi me Zyren e Regjistrimit te Pronave dhe me Gjendjen Civile do te perbeje nje burim te pakontestueshme dhe real te gjendjes se prones dhe pronarit, e cila do te sherbeje si baze ne llogaritjen e takses perkatese.

KERKESAT TEKNIKE

Kerkesat teknike per sistemin

Serveri do te instalohet fizikisht ne ambjentet e Bashkise. Bashkia do te vere ne dispozicion ambjen te siguruar per qasje te kufizuar dhe te monitoruar. Bashkia do te siguroje ushqimin e panderprere me energji elektrike.

Meqenese sistemi do te jete i qenderzuar ne Bashkine e Skraparit dhe aty do te lokalizohet infrastruktura hardware dhe ajo software, lind nevoja e vendosjes se nje komunikimi te sigurte, te besueshem dhe te panderprere midis njesive administrative dhe Bashkise. Per te realizuar nje rrjet te tille komunikimi, fillimisht do te sigurohen linja komunikimi ndermjet njesive dhe Bashkise e cila nuk eshte pjese e ketij projekti. Ajo qe duhet te sigurohet nepermjet ketij projekti, eshte blerja dhe konfigurimi i serverit per instalimin e sistemit, ne menyre qe te aksesohet me tej nga perdoruesit fundor.

Specifikimet teknike te serverit

| | |
|--|---|
| Memorja | Maksimumiisupportuar 512 GB |
| Memorje e perfshire | 16 GB |
| Storage Controller | SAS Raid Controller, qesupporton: RAID 0/1/1+0/5 |
| Nr. maksimalivendeve per HDD | Min. 8 HDD, hot-plug |
| HDD tepershira dhe konfigurimi i RAID-it | Min. HDD 2x600GB 10K SAS in RAID 1 |
| DiskuOptik | DVD-ROM/CDRW drive |
| Rrjeti | minimumi 4 x 1 Gb Ethernet; 1 Management Port |
| Power supply | 2, Redundant Power Supply, hot-plug |
| Operating Systems | Microsoft Windows Server (2012 R2, 2012 and 2008 R2 etj), Linux, etj. |
| Garancia | 3 Vjet |
| | |

